



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Oda e infermierëve, mamive dhe profesionistëve tjerë shëndetësor të Kosovës
Komora medicinskoh sестara, babica i ostalih zdravstvenih stručnjaka Kosova
The Kosovo Chamber of nurses, midwives and other health professionals



KUVENDI I ODËS SË INFIERMIERËVE, MAMIVE DHE PROFESIONISTËVE TJERË SHËNDETËSORË TË KOSOVËS (OIK), në mbështetje të nenit 19, paragrafi 1 me nën-paragrafin 1.1 të Ligjit 04/L-150 për Odat e Profesionistëve Shëndetësor, Neni 19, paragrafi 1 me nën-paragrafin 1.1 të Statutit të Odës së Infermierëve të Kosovës, në mbledhjen e mbajtur me datë 27.02.2026 nxjerrë këtë:

V E N D I M

Për plotësim-ndryshimin e Rregullores për Regjistrimin dhe Anëtarësimin e Profesionistëve në OIK, me nr. prot. 769, të datës 01.07.2024

- Miratohet plotësim-ndryshimi i Rregullores për Regjistrimin dhe Anëtarësimin e Profesionistëve në OIK, me nr. prot. 769, të datës 01.07.2024
- Neni 5 i kësaj Rregulloreje, paragrafi 3, plotësohet me nënparagrafët si në vijim:
 - 3.6 “Licenca e punës nga vendi i origjinës”;
 - 3.7 “Leja e punës e lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë”;
 - 3.8 “Vërtetimi nga Oda përkatëse nga shteti, shtetësinë e të cilit e ka aplikuesi”.
- Neni 9 i kësaj Rregulloreje, pika 3, ndryshohet dhe riformulohet si në vijim: “Kartela e anëtarësisë është pronë e Odës dhe, si e tillë, duhet t’u dorëzohet organeve kompetente të Odës në rast të çregjistrimit të profesionistit nga Regjistri i Anëtarësisë së OIK.”
- Neni 10, paragrafi 2, ndryshohet dhe riformulohet si në vijim: “Nëse një anëtar i Odës nuk paguan tarifën e anëtarësisë brenda gjashtë (6) muajve, Shërbimi Profesional merr vendim për përfundimin e anëtarësimin në Odë. Anëtari fshihet nga Regjistri i Anëtarëve të Odës dhe humb të gjitha të drejtat që rrjedhin nga anëtarësimi i tij në Odë, përfshirë të drejtën për licencë.”
- Neni 11, paragrafi 2, plotësohet me paragrafin 3 si në vijim: “Dokumentet që duhet të dorëzohen me rastin e paraqitjes së kërkesës për çregjistrim në OIK janë:
 - 3.1 Kartela e anëtarësisë;
 - 3.2 Licenca e punës në origjinal;
 - 3.3 Dëshmia për përmbushjen e të gjitha obligimeve ndaj OIK deri në momentin e paraqitjes së kërkesës për çregjistrim.”
- Neni 12, paragrafi 2, plotësohet dhe ndryshohet si në vijim: “Taksa administrative për regjistrim caktohet për periudhën një (1) vjeçare.
- Ndryshimet dhe plotësimet e miratuara me këtë vendim i bashkëngjiten Rregullores dhe zbatohen si pjesë përbërëse e saj.
- Dispozitat e tjera të Rregullores mbeten të pandryshuara.
- Ky vendim hyn në fuqi në ditën e miratimit.

I’ dërgohet:

- Zyrës Ligjore
- Zyrës së Anëtarësisë
- Zyrës së Financave
- Zyrës së IT-së
- Arkivit



Kryetarja e OIK
Nexhmije Gori